Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 07 Prill 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa me numër KB-1680/22; Nr.4933 e parashtruar nga pala
– në emër të nënës – bashkëshortja e bartësit të së drejtës banesore
(i ndjerë) e përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 07 prill 2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga NSH: “Iligja” – Banjë e Pejës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 07.04.2023 me anë të cilit refuzohet si e pa bazuar kërkesa e palës – në emër të nënës – bashkëshortja e bartësit të së drejtës banesore (i ndjerë) për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim NSH: “Iligja” – Banjë e Pejës.

kishte parashtruar kërkesë për blerjen e banesës paraprakisht me date 16.01.2015, dhe te njëjtit iu është refuzuar kërkesa për blerjen e banesës me vendim te BD- 86/9 date 014.02. 2017, ne mungese te dokumentacionit si vendimin mbi ndarjen e banesës dhe kontratën mbi shfrytëzimin e banesës. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën për rishqyrtim të vendimit, nuk ka arritur të argumentoj me anë të provave se është bartës i të drejtës banesore. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk mund të kualifikohet si bartës i së drejtës banesore me arsyetimin se janë vlerësuar te gjitha provat e dorëzuara ne bashkëngjitje te kërkesës nr. 4933, dhe gjeti se mungon Kontrata mbi shfrytëzimin e banesës dhe Vendimi mbi ndarjen e banesës me BVI Banesore; Komisioni edhe pas përpjekjeve për te siguruar dokumente shtese, pala nuk ka arritur te siguroj dokumentet ne fjale, por ka siguruar dokumente tjera te cilat nuk e kane bindur Komisionin. Andaj Komisioni ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore te parapara me nenin 1 dhe nenin 3, paragrafi 1.6 , lidhur me nenin 37 dhe 38 te ligjit për Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 11/83- 29/86 dhe 42/86). Nga te lartcekurat kërkesa për blerjen e banesës Komisioni rekomandoi te refuzohet si e pabazuar. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës, të cilat shërbejnë si bazë për realizimin e blerjes së banesës, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 27 Prill 2023



Suzana Dautaj / Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/18

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 07 Prill 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rrethat e Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 Prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Agjencia shpallet jo kompetente në rastin sa i përket kërkesës me numër KB-1656/22; Nr.2400 e palës _____ përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 07.04.2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga "Ministria e Punëve të Brendshme, SAPK NR.32/73" Kaqanik.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 07 Prill 2023 me anë të cilit Agjencia shpallet jokompetente sa i përket kërkesës së palës _____ për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim "Ministria e Punëve të Brendshme, SAPK NR.32/73" Kaqanik.

Pasi që Kërkesa për blerjen e banesës e parashtruar nga _____ ka të bëjë me banesën e cila është ndarë në shfrytëzim sipas Vendimit nga "Ministria e Punëve të Brendshme, SAPK NR.32/73" Kaqanik, i cili subjekt nuk bie nën juridiksionin administrativ të Agjencisë, Agjencia shpallet jo kompetente për shqyrtimin e së njëjtës.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 Prill 2023.



Syza Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/19

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 07 Prill 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 Prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Agjencia shpallet jo kompetente në rastin sa i përket kërkesës me numër KB-1716/23; Nr.1009 e palës përshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 07.04.2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga Kuvendi Komunal Suharekë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 07 Prill 2023 me anë të cilit Agjencia shpallet jokompetente sa i përket kërkesës së palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga Kuvendi Komunal Suharekë.

Pasi që Kërkesa për blerjen e banesës e parashtruar nga ka të bëjë me banesën e cila është ndarë në shfrytëzim nga Kuvendi Komunal Suharekë, i cili subjekt nuk bie nën juridiksionin administrativ të Agjencisë, Agjencia shpallet jo kompetente për shqyrtimin e së njëjtës.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 Prill 2023.



Syzana Dautaj
Syzana Dautaj -Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/20

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 07 Prill 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banesave mbi të cilat ekziston e drejta banesore. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 Prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Agjencia shpallet jo kompetente në rastin sa i përket kërkesës me numër KB-1580/19; Nr.9962 e palës përshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banesave të datës 07.04.2023 për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga "Ministria e Punëve të Brendshme"- SUP, Prizren.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 07 Prill 2023 me anë të cilit Agjencia shpallet jokompetente sa i përket kërkesës së palës për blerjen e banesës të ndarë në shfrytëzim nga "Ministria e Punëve të Brendshme"- SUP, Prizren.

Pasi që Kërkesa për blerjen e banesës e parashtruar nga ka të bëjë me banesën e cila është ndarë në shfrytëzim nga "Ministria e Punëve të Brendshme"- SUP, Prizren, i cili subjekt nuk bie nën juridiksionin administrativ të Agjencisë, Agjencia shpallet jo kompetente për shqyrtimin e së njëjtës.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 Prill 2023.



Syza Dautaj
Syza Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/21

Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të raportit të datës 07 Prill 2023 të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe në përputhje me Ligjin Nr. 8/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247; Politikat Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rregullat e Komisionit për Shitjen e Banësive mbi të cilat ekziston e drejta banesore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 Prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Agjencia shpallet jo kompetente në rastin sa i përket kërkesës me numër KB-1395/16; Nr.2674 e parashtruar nga Sharr Pllana përfshirë në Raportin e Komisionit për Shitjen e Banësive të datës 07.04.2023 për blerjen e objektit të ndarë në shfrytëzim nga BVI për Banim ne Prishtinë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për shitjen e banesave të datës 07 Prill 2023 me anë të cilit Agjencia shpallet jokompetente sa i përket kërkesës së palës Sharr Pllana për blerjen e objektit/garazhës të ndarë në shfrytëzim nga BVI për Banim ne Prishtinë.

Pasi që Kërkesa për blerjen e banesës e parashtruar nga Sharr Pllana ka të bëjë me objekt/garazhë e cila është ndarë në shfrytëzim nga BVI për Banim ne Prishtinë, i cili subjekt nuk bie nën juridiksionin administrativ të Agjencisë, Agjencia shpallet jo kompetente për shqyrtimin e së njëjtës.

Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115), Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe pasi që pala nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për blerjen e banesës, të cilat shërbejnë si bazë për realizimin e blerjes së banesës, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 Prill 2023



Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/22

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtocës së po të njëjtit Ligji, nenit 10.1.7 të Rregullores për qiradhënien e aseteve të NSH-ve – 31 Gusht 2022, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të parcelës nr. P-73409082-00024-0 me sipërfaqe 21992 m² në pronësi të NSH "KB Kosova" PRN082, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 2,400.00 për një vit për palën kompania "Pro Beton" Sh.P.K. përfaqësuar nga Fitim Emini.
- II. Aseti të vendoset për qiradhënie me tender publik.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxhmenti për qiradhënie direkte të parcelës në pronësi të NSH "KB Kosova" PRN082, sipas përshkrimit në dispozitiv të këtij vendimi.

Bordi vlerësoi se shpallja publike për qiradhënie të këtij asetit duhet të bëhet në mënyrë më gjithëpërfshirëse ashtu që publiku të ketë qasje më të gjerë në informatat për tenderin. Në këtë mënyrë rritet konkurrencshmëria dhe çmimet e ofruara për pronën shoqërore. Nëse shpallet tenderi për këtë aset, rritet konkurrencshmëria dhe mund të arrihet çmim më i lartë që do mundësonte të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta. Ndërmarrja në fjalë do të jetë si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 prill 2023.



Syza Dautaj - Surdulli
Syza Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/23

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 prill 2023 nxirr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh IFS Progres (në likuidim) PRZ034, nga Rajoni i Prizrenit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh IFS Progres PRZ034.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DHPGJS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbljedhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të NSh IFS Progres (në likuidim) PRZ034.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 prill 2023



Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/24

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 04/2020 për Politikën dhe procedurat e likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 Prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobimet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet nr. P-71006015-00028-32 me sipërfaqe prej 968 m²; P-71006015-00028-33 me sipërfaqe prej 388 m²; P-71006015-00028-34 me sipërfaqe prej 4349 m² dhe P-71006015-00028-35 me sipërfaqe prej 1504 m² ZK Dush dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.
- I. Pas aprovimit të kësaj kërkesë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
- II. Ky vendim do të hyj në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për heqje dorë nga asetë respektivisht nga ngastrat kadastrale nr. 00028-32; 00028-33 dhe 00028-35 që janë objekt i kësaj kërkesë shfrytëzohen si rrugë publike nga banorët e fshatrave përreth, ndërsa parcela 00028-34 shfrytëzohet në tërësi si varreza në ZK Dush.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se asetet nuk është fitimprurëse dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike."

Për më tepër, heqja dorë nga këto asete nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit. Po ashtu, Autoriteti i Likuidimit i ka dërguar Kryetarit të Komunës së Junikut më datë 25 gusht 2022, kërkesë që të konfirmojë që parcela shfrytëzohet si rrugë ku edhe është pranuar përgjigje më datë 12 shtator 2022, përmes së cilës është konfirmuar se kjo parcelë shfrytëzohet si rrugë publike. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 Prill 2023.



Syza Dautaj
Syza Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/25

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, dhe nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit për AKP-në; nenin 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; si dhe nenin 3.13.1 të Rregullores Nr. 4/2020 për Politikën dhe Procedurën e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 Prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprobimet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të dy hapësirave në katin përdhese dhe një në katin e I në objektin shumëkatësh (identifikuar në gjeoportale me numër O-07116-1-69-0), me një sipërfaqe totale prej 299.55m² të NSh "Kompania e Sigurimeve Dunav" PRN180, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 2,126.00 për një muaj.

II.

III. Udhëzohet Autoriteti i Likuidimit që për periudhën e shfrytëzimit në mënyrë të paautorizuar para korrikut 2022, të paraqesë padi për kompensimin e dëmit në emër të qirasë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

IV. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtoreve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit dhe Menaxhmenti për qira direkte për asetet e PRN180 "Kompania e Sigurimeve Dunav" sipas kërkesës së Kompanisë "Eurosig". Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Hapësirat afariste në banesën kolektive me numër O-07116-1-69-0, dy në katin përdhese dhe një në katin e I, me një sipërfaqe totale prej 299.55m² shfrytëzohen nga ana e kompanisë "Eurosig" dhe janë hapësira të renovuara nga ana e tyre dhe kështu qiradhënia e këtij është e arsyeshme pasi që do të lehtësonte ushtrimin e veprimtarisë biznesore të kompanisë dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij.

Pasi që NSh "Kompania e Sigurimeve Dunav" ka hyrë në procedurë të likuidimit, Autoriteti i Likuidimit i ka dërguar shkresë më datë 19 qershor 2020, ku i ka kërkuar që të lirojë asetin ose të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë. Më datë 22.07.2020 është pranuar përgjigja nga ana e Kompanisë "Eurosig" ku

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
eek.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

shfaqin pretendimet e tyre pronësore dhe pretendojnë që AKP nuk ka ndonjë bazë ligjore për të kërkuar që të lirojnë asetet ose hyjnë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë. Për më tepër, në mesin e argumenteve të theksuara nga ana e kompanisë "Eurosig" është edhe fakti që për një aset tjetër të NSh "Kompania e Sigurimeve Dunav" Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme ka lëshuar urdhërin për masë të përkohshme nr. C-III-17-0241 në favor të "Eurosig". Gjithashtu, "Eurosig" në mesin e pretendimeve të tjera thekson që KS "Dardania" është trashëgimtare pasuese e NSh "Kompania e Sigurimeve Dunav" dhe se me vendimin e BQK-së nr. 52-23/2015 të datës 17.11.2015 është bërë ndërrimi i emrit nga KS "Dardania" në "Eurosig".

Edhe përkundër hezitimeve nga ana e Kompanisë "Eurosig" zyrtarët e Autoritetit të Likuidimit kanë komunikuar disa herë përmes e-mailit dhe kanë zhvilluar takime me përfaqësues të Kompanisë "Eurosig" ku edhe janë bindur që të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë.

Duke pasur parasysh çështjet pronësore të pa zgjidhura, ku këto hapësira nuk evidentohen në emër të NSh "Kompania e Sigurimeve Dunav" dhe lëndët që janë në shqyrtim e sipër në Dhomën e Posaqme të Gjykatës Supreme dhe pretendimet pronësore të vet palës që do të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, atëherë Autoriteti i Likuidimit ka konsideruar që kërkesa për borxhin për periudhën retroaktive duhet të jetë nga periudha që kompania "Eurosig" ka pranuar të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, dhe me datë 05 korrik 2022, përfaqësuesit e kompanisë "Eurosig" kanë pranuar që të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, dhe kështu do të jetë e arsyeshme që pagesa retroaktive para nënshkrimit të kontratës së qirasë, të jetë prej korrikut 2022. Për periudhën para korrikut 2022 të shfrytëzimit nga ana e Kompanisë "Eurosig" pas këtij vendimi të Bordit të AKP-së, Autoriteti i Likuidimit do të parashtrijë padi në Dhomën e Posaqme të Gjykatës Supreme, duke kërkuar kompensimin e dëmit bazuar në shfrytëzimin e paligjshëm të këtyre aseteve.

Kompania "Eurosig" është duke i shfrytëzuar parcelat e lartëshënuara, atëherë në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit për çështje të pagesës retroaktive do të llogaritet periudha nga korriku 2022 për arsyet që u cek më lartë.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 Prill 2023.



[Signature]
Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/26

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, dhe nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit për AKP-në; nenin 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; si dhe nenin 3.13.1 të Rregullores Nr. 4/2020 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore nenit 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 Prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të parcelës 1755/12 zona kadastrale Llapllasellë, me sipërfaqe totale prej 1718 m2 në pronësi të NSH "Ratar" PRN115, sipas kërkesës së palës kompania "Arjeta Group" përfaqësuar nga Afrim Durnishi sipas përcaktimit të çmimit të qirasë nga Komisioni me vlerë të përgjithshme prej € 420.00 për një muaj
- II. Udhëzohet Autoriteti i Likuidimit që për periudhën e shfrytëzimit në mënyrë të paaautorizuar, të paraqesë padi për kompensimin e dëmit në emër të qirasë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit dhe Menaxhmenti për qiradhënie direkte të asetit/parcelës 1755-11 zona kadastrale Llapllasellë, pronë e PRN115 NSH "Ratar", sipas përshkrimit në paragrafi I të dispozitivit të këtij vendimi.

Bordi vlerësoi se shpallja publike për qiradhënie të këtij asetit duhet të bëhet në mënyrë më gjithëpërfshirëse ashtu që publiku të ketë qasje më të gjerë në informatat për tenderin. Në këtë mënyrë rritet konkurrencshmëria dhe çmimet e ofruara për pronën shoqërore. Nëse shpallet tenderi për këtë aset, rritet konkurrencshmëria dhe mund të arrihet çmim më i lartë që do mundësonte të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurt. Ndërmarrja në fjalë do të jetë si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 Prill 2023.



Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-179/27

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenit 18.1.3, dhe neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit për AKP-në; nenin 10, paragrafi 1.5 i Rregullores Nr. Nr. 04/2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; si dhe nenin 3.13.1 të Rregullores Nr. 4/2020 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 Prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të parcelave nr. 1840/0; 1846/0; 1848/0; 1852/0; 1855/0; 1857/0; 1858/1 dhe 1864/0 zona kadastrale Llapllasellë, me sipërfaqe totale prej 29335 m² në pronësi të NSh "Ratar" PRN115, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 3,756.00 për një vit.
- II. Refuzohet pjesërisht propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të parcelave nr. 1822/0; 1823/0; 1825/0 dhe 1834/2 ZK Llapllasellë me sipërfaqe totale prej 18307 m² dhe udhëzohet menaxhmenti i AKP-së dhe Autoriteti i Likuidimit që këto parcela të i vendosë në listë të aseteve për qiradhënie përmes tenderit publik.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti të Likuidimit dhe Menaxhmenti për qira direkte për asetet e NSh "Ratar" PRN115 sipas kërkesës nga kompania "Lika Group AG" përfaqësuar nga Fatmir Likaj. Bordi vlerësoi se lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Parcelat nr. nr. 1840/0; 1846/0; 1848/0; 1852/0; 1855/0; 1857/0; 1858/1 dhe 1864/0 zona kadastrale Llapllasellë janë në kufi me objektin e kompanisë dhe nuk kanë qasje në rrugë dhe janë përreth pronave private të Esat dhe Fatmir Likaj të cilët janë edhe pronar të "Likaj Group AG" dhe kështu qiradhënia e këtyre aseteve/parcelave është e arsyeshme pasi që do të lehtësonte ushtrimin e veprimtarisë biznesore të kompanisë dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij. Bordi vlerësoi se qiradhënia e këtyre aseteve/parcelave nr. nr. 1822/0; 1823/0; 1825/0 dhe 1834/2 zona kadastrale Llapllasellë pasi që kanë qasje në rrugë duhet të bëhet në mënyrë më gjithëpërfshirëse ashtu që publiku të ketë qasje më të gjerë në informatat për tenderin. Në këtë mënyrë rritet konkureshmëria dhe çmimet e ofruara për pronën shoqërore. Nëse potencialisht shpallet tenderi për këto asete mund të arrihet çmim më i lartë që do mundësonte të ardhura të vazhdueshme dhe të sigurta. Ndërmarrja në fjalë do të jetë si përfitues nga inkasimi i të hyrave nga qiratë. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 27 Prill 2023.




Syzana Dautaj-Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-179/28

Në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitjen Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore; Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 27 Prill 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet rekomandimi i Njësisë për Negocim Direkt për vazhdimin e afatit për pagesën e çmimit final për blerjen e pronës shoqërore përmes shitjes direkt edhe për 60 ditë tjera.
- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të vazhdoj tutje me përmbylljen e kontratave, pas realizimit të pagesave nga palët sipas afatit të paraparë në këtë vendim.
- III. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e datës 09.03.2023 kishte udhëzuar Menaxhmentin e AKP-së që të paraqes një përmbledhje të rasteve të prezantuara në Bord, e për të cilat është propozuar vazhdimi i afatit të pagesave parashtruesve të kërkesave për blerje direkte të asetëve. Të gjitha këto raste, ishin aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së, mirëpo parashtruesit e kërkesave nuk i kanë bërë pagesat sipas afateve të përcaktuara me Rregullore dhe vendimet e Bordit.

Po ashtu, Bordi i AKP-së ka kërkuar shqyrtimin dhe analizimin e bazës ligjore të këtyre kërkesave/miratimeve, respektivisht nëse kjo kategori e kërkesave ka qenë në pajtim me Rregulloret që kanë qenë në fuqi në kohën kur janë aprovuar kërkesat duke u bërë edhe një krahasim të kriterëve ligjore dhe pajtueshmëria e tyre edhe me Rregulloren Nr. 06/2022 për Shitjen Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Pas kontrollit të kërkesave të cilat janë paraqitur në Bord për vazhdimin e afatit për pagesa, është konstatuar se të gjitha kërkesat kanë qenë të kualifikuara për shitje direkte në pajtueshmëri me rregulloret në fuqi, pasi që bëhet fjalë për ndërtime të pa penguara në tokën e ndërmarrjeve shoqërore, e cila kategori përfshihet edhe në Rregulloren nr. 06/2022 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Të gjitha janë shtëpi banimi dhe janë kategori e ekonomive familjare.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 27 Prill 2023.



Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës